REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Librazhd më: 21.06.2024

**NJOFTIM**
**"PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË"**

Z.znj.________________________________

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Premte**, **datë 28.06.2024**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Qershor** 2024.Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. **P/Vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha Maj 2024".
2. **P/Vendim "** Për shpërndarjen e një pjese të fondit financiar të Mc të vitit 2024 për: Familjet e z.Hajdar Rreshka dhe Ramazan Kullolli,banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore dhe dhënien e Ndihmës Financiare nga ana e Bashkisë Librazhd".
3. **P/Vendim "** Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dhënien e Ndihmës Financiare për familjen e z.Ymer Daja banor i fshatit Vehçan Nj/A Hotolisht banesa e të cilit ka pësuar fatkeqësi natyrore(rrëshqitje trualli).
4. **P/Vendim "** Ndihmë Financiare".
5. **P/Vendim "** Për një ndryshim dhe shtesë në V.K.B-në nr 108,dt 30.11.2023 " Për miratimin e Paketës Fiskale( taksave dhe tarifave vendore),në Bashkinë Librazhd për vitin 2024".
6. **P/Vendim "**Për miratimin e listës shtesë të familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2024".
7. **P/Vendim "**Miratimin e programit të punës për parandalimin dhe masat që do të merren në mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri".
8. **P/Vendim** " Për vlersimin me titull "Qytetar Nderi Z.Arif Lushi dhe Znj.Hatixhe Lushi".

9. **Të ndryshme;**

- Ditën e Enjte datë 27.06.2024 ora 09:00 të mblidhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I KËSHILLIT
**Mitat BIÇAKU**

REPUBLIKA E SHQIPERISË
NJESIA ADMINISTRATIVE................................
NDIHMA EKONOMIKE & SHERBIMET SOCIALE

PROJEKT - VENDIM
Nr. .Datë .2024
Mbi dhënien e Ndihmës Ekonomike
nga fondi i Kushtezuar 6%
( *Periudha: Maj 2024* )

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike" Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndihmës Ekonomike"

Nisur sa më lart nga verefikimi i sistemit elektronik i Ndihmes Ekonomike rezulton se jane refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 73 Familje, dhe propozohet:
1-Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% : Gjithsej 73 Familje me një fond: 338,241 lekë.
2.Te mos perfitojne per arsye te mos plotesimit te kritereve nga fondi i kushtezuar 6% 1 familje.
3.Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
4.Ngarkohen per zbatimin e ketij Projekt-vendimi Administratoret Shoqeror te Ndihmes Ekonomike ne Njesite Administrative.
5.Ky Projekt-vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes se Vendimit

Drejtori i Shërbimeve Sociale
Rexhep Shaka

Pergj / Sekt.Nd.Ekonomike
Selime Ozuni

**KRYETARI I BASHKISË**
**MARIGLEN DISHA**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA LIBRAZHD

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**NJESIA ADMINISTRATIVE ................................**

# RELACION

Nr.......... datë ..................
Mbi Dhënien e Ndihmës Ekonomike
nga Fondi i Kushtezuar 6%
( *Periudha:Maj 2024* )

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike" percaktohet qarte se kush mund ta perfitoje kete ndihme nga fondi i kushtezuar 6% i bllok ndihmes ekonomike.

E rendesishme eshte qe familjet qe nuk klasifikohen si perfituse ne sistemin eloktronik te ndihmes ekonomike me pike te pa mjaftushme te verefikohen saktesisht nga Administratori Shoqerore i Ndihmes Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike ,sociale,shoqerore dhe duke pasur parasysh kriteret qe jane miratuar ne Keshillin Bashkiak ta vlersoje familjen ne se duhet apo jo qe te klasifikohet si familje qe duhet te perfitoje ndihme ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik ne familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 73 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 73 familje .

2- Te mos perfitojne 1 familje.

**Njesitë Administrative:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Njësia Administrative Qytet | 35 Familje me fond | 163,246 lekë |
| 2. | Njësia Administrative Hotolisht | 13 Familje me fond | 65,750 lekë |
| 3. | Njësia Administrative Polis | 11 Familje me fond | 46,397 lekë |
| 4. | Njësia Administrative Qendër | 10 Familje me fond | 42,294 lekë |
| 5. | Njësia Administrative Orenjë | 4 Familje me fond | 20,554 lekë |

**Totali si Bashki 73 familje me fond 338,241 lekë**

## Relacion per Familjet e Refuzuara

- Familjet qe nuk jane rekomanduar per tu trajtuar nga fondi 6 %.me arsyet perkatese per cdo familje jane si me poshte:

| **Emri Atesia Mbiemri** | **Refuzuar/Arsyeja** |
|---|---|
| **Njesia Qender** | |
| 1.Xhafer Seit Karaj | Nuk eshte rekomanduar te 6 % pasi ka kaluar afatin vjetor.Do te riaplikojne ne sistem. |

**Pergj / Sekt.Nd.Ekonomike**
Selime Ozuni

**BASHKIA LIBRAZHD**

**FONDI 6 %**

**MAJ 2024**

| Nr | Emri i Aplikantit | NID | Statusi aplikimit | Vlera e përllogaritur për fondin 6% | Kompensimi i Energjisë | Totali | Numri anëtarëve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Jonuz Shahin Çota | G30206013H | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 3 |
| 2 | Avni Reshit Stafa | H20620213J | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 3 | Xhemile Xhelo Alliu | G75616178K | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 4 | Katerina Urim Stafa | K06111008G | manduar per trajtim me fondir | 5940 | 1288 | 7228 | 2 |
| 5 | Sulejman Selim Roçi | G30508206K | manduar per trajtim me fondir | 1525 | 1288 | 2813 | 2 |
| 6 | Fatbardha Dalip Kurti | G45320047G | manduar per trajtim me fondir | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 7 | Lefterije Selaudin Nogu | I85810017C | manduar per trajtim me fondir | 5940 | 1288 | 7228 | 2 |
| 8 | Ramadan Hamit Hila | G80308080E | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 9 | Sami Idriz Gançi | G40414066V | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 10 | Eduart Xhevit Pali | I10524158W | manduar per trajtim me fondir | 5881 | 1288 | 7169 | 4 |
| 11 | Xhemile Fehta Menalla | G95208071N | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 12 | Nazmi Hazis Sina | G10420107U | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 13 | Vero Elmaz Duka | G30212084C | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 13 | **Total Njësia Administrative: Hotolisht** | | | 49006 | 16744 | 65750 | 26 |
| 1 | Dritan Nazmi Brahja | I30216010M | manduar per trajtim me fondir | 2178 | | 2178 | 1 |
| 2 | Rajmonda Luan Zylali | I26014010H | manduar per trajtim me fondir | 5940 | 1288 | 7228 | 2 |
| 3 | Skenderie Petrit Xhabli | J15522025P | manduar per trajtim me fondir | 5940 | | 5940 | 2 |
| 4 | Mirjana Abdulla Çollaku | G76014110Q | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 5 | Ahmet Islam Balla | G00201028D | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 6 | Ardi Osman Elezi | I61115008U | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 7 | Iva Zini Shehu | J25701027C | manduar per trajtim me fondir | 5881 | | 5881 | 5 |
| 8 | Shyqyrije Qazim Shpata | D66211004W | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 9 | Artur Musa Agastra | G10101021O | manduar per trajtim me fondir | 2178 | | 2178 | 1 |
| 10 | Hyrije Adem Çota | E55210169R | manduar per trajtim me fondir | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Shyqyrie Belul Blloshmi | G65107079J | manduar per trajtim me fondir | 6732 | 1288 | 8020 | 2 |
| 12 | Tahire Qamil Balla | G35812017F | manduar per trajtim me fondir | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 13 | Vule Kadri Topi | F75710021A | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 14 | Farije Sefedin Topi | G05328025M | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 15 | Qamil Selman Ferra | F80501032B | manduar per trajtim me fondir | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 16 | Olsi Nazmi Dosku | H50108018L | manduar per trajtim me fondir | 2178 | | 2178 | 1 |
| 17 | Fatmira Hysen Gjorga | G15420041E | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 18 | Luljeta Hashim Zajaku | H35210033G | manduar per trajtim me fondir | 1525 | | 1525 | 1 |
| 19 | Kujtim Hasan Buzra | F90826008C | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 20 | Bule Myhedin Kojku | H55125015N | manduar per trajtim me fondir | 7920 | 1288 | 9208 | 3 |
| 21 | Nasibe Ismail Hunçi | G45229211O | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 22 | Manushaqe Ferit Shkurti | H15712010O | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 23 | Irena Agim Balazi | I65427026D | manduar per trajtim me fondir | 5940 | 1288 | 7228 | 2 |
| 24 | Fatmira Beqir Hysa | H70522017S | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 25 | Jonida Faik Hunçi | I75522027N | manduar per trajtim me fondir | 5940 | 1288 | 7228 | 2 |
| 26 | Aishe Sulejman Belba | G15213055C | manduar per trajtim me fondir | 3146 | 0 | 3146 | 1 |
| 27 | Leonard Enver Brasha | J60806018C | manduar per trajtim me fondir | 2178 | | 2178 | 1 |
| 28 | Qanije Refat Brasha | F95520031H | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 29 | Sabije Livan Zyka | F66018008Q | manduar per trajtim me fondir | 5720 | 1288 | 7008 | 1 |
| 30 | Xhevahire Haziz Biçaku | G45120093D | manduar per trajtim me fondir | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 31 | Bujar Bajram Bahidi | G80316015M | manduar per trajtim me fondir | 1525 | 1288 | 2813 | 2 |
| 32 | Piro Ferit Halili | H70320023A | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 3 |
| 33 | Blerina Qamil Dobrenji | I56005014U | manduar per trajtim me fondir | 5940 | | 5940 | 2 |
| 34 | Miranda Bashkim Kopaçi | I36221009W | manduar per trajtim me fondir | 3960 | 1288 | 5248 | 2 |
| 35 | Grigori Faik Cani | I30108161S | manduar per trajtim me fondir | 12672 | | 12672 | 5 |
| 35 | **Total Njësia Administrative: Librazhd** | | | 138774 | 24472 | 163246 | 57 |
| 1 | Besnik Belul Hida | G70626072T | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 2 | Enver Mexhit Kaca | F80502085T | manduar per trajtim me fondir | 6138 | 1288 | 7426 | 3 |
| 3 | Kadrije Riza Kaca | E85608004U | manduar per trajtim me fondir | 3146 | | 3146 | 1 |
| 4 | Ndriçim Qemal Disha | G80228110M | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 4 | **Total Njësia Administrative: Orenje** | | | 16690 | 3864 | 20554 | 8 |
| 1 | Sadik Riza Zaimi | G30325115M | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 2 | Shyqyri Seit Alimeta | E20222004Q | manduar per trajtim me fondir | 4752 | | 4752 | 2 |
| 3 | Xhevahir Kadri Doçi | H40517080G | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 4 | Xhemal Shaban Zharri | G00120136A | manduar per trajtim me fondir | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 5 | Faik Ismail Bufi | G60327051P | manduar per trajtim me fondir | 2178 | 1288 | 3466 | 2 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Astrit Shefqet Cura | H30624055Q | manduar per trajtim me fondi | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 7 | Bejaze Fejzulla Stërmugu | G15408018C | manduar per trajtim me fondi | 3146 | 0 | 3146 | 1 |
| 8 | Hava Hamit Hasani | G65823039B | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 9 | Imer Sali Ballolli | G30520374Q | manduar per trajtim me fondi | 3703 | 1288 | 4991 | 2 |
| 10 | Farije Hamit Lleshi | E15319014U | manduar per trajtim me fondi | 3146 | | 3146 | 1 |
| 11 | Sabrie Sadik Shata | G95605100F | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 11 | **Total Njësia Administrative: Polis** | | | 36093 | 10304 | 46397 | 18 |
| 1 | Isuf Jonuz Seferi | D60826014S | manduar per trajtim me fondi | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 2 | Mereme Mehmet Çerri | C75607020R | manduar per trajtim me fondi | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 3 | Margarita Sami Faqolli | H75401220T | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 4 | Sanije Shefqet Alija | G65125222I | manduar per trajtim me fondi | 5940 | 1288 | 7228 | 2 |
| 5 | Ylli Tafil Mema | H20101027S | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 2 |
| 6 | Sabire Xhemal Shuli | A55716002R | manduar per trajtim me fondi | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 7 | Sulejman Harun Çota | F20728042F | manduar per trajtim me fondi | 3146 | 1288 | 4434 | 1 |
| 8 | Tefta Asllan Hoxha | G86222012E | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 9 | Renaldo Lavdim Karaj | J71031016V | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 10 | Fiqirete Ymer Rruplli | H85916021Q | manduar per trajtim me fondi | 2178 | 1288 | 3466 | 1 |
| 10 | **Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHD** | | | 29414 | 12880 | 42294 | 12 |
| 73 | **TOTALI BASHKISE** | | | 269977 | 68264 | 338241 | 121 |

REPUBLKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
Sektori i Mbrojtjes Civile

# PROJEKT - VENDIM

**Nr.______ datë ___/___/2024**

**PËR SHPERNDARJEN E NJE PJESE TE FONDIT FINANCIAR TE MC TE VITIT 2024 PER :FAMILJET E Z : HAJDAR RRESHKA DHE RAMAZAN KULLOLLI BANESAT E TE CILEVE JANE DEMTUAR NGA FATKEQESI NATYRORE DHE DHENIEN E NDIHMES FINANCIARE NGA ANA E BASHKISE LIBRAZHD .**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dt___ /___ / 2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i MC dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar " Per shperndarjen e nje pjese te fondit financiar te MC te vitit 2024 per :
Familjet e z: **Hajdar Rreshka dhe Ramazan Kullolli** te demtuar nga fatkeqesi natyrore dhe dhenien e ndihmes financiare nga ana e Bashkise Librazhd bazuar ne :

1-Ligji nr 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore"

2- Ligjin nr 45/2019 "Per Mbrojtjen Civile "

3- VKM nr 329 dt 16.05.2012 " Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuar nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore " .

4-VKB nr 119 dt 29.12.2023 "Per miratimin e Buxhetit te Bashkise Librazhd per vitin 2024"

**VENDOSI :**

**1-** Te miratoje fondin financiar te kompesimit prej **182.982 leke** per familjen e shtetasit **Hajdar Rreshka** banesa e te cilit eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore **, (sipas te dhenave ne listen b/ngjitur ).**

**2-**Te miratoje fondin financiar te kompesimit prej **116.856 leke** per familjen e shtetasit **Ramazan Kullolli** banesa e te cilit eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore ,**(sipas te dhenave ne listen b/ngjitur ).**

**3- Burimi i financimit do te jete nga Fondi i kushtezuar i Buxhetit te Shtetit dedikuar per MC per vitin 2024 Bashkise Librazhd) .**

**4-**Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar si dhe Sektori i EC.

**5-** Ky vendim hyn ne fuqi 10 dit pas shpalljes publike ( sipas percaktimeve te Ligjit 139/2015)

**KRYETARI I BASHKISE**
**Mariglen DISHA**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**SEKTORI MBROJTJES CIVILE**

**MIRATOHET**
**KRYETARI I BASHKISE**
**Mariglen DISHA**

**PASQYRA ME TE DHENAT PER KOMPESIM FINANCIAR PER SHTETASIT : HAJDAR RRESHKA DHE RAMAZAN KULLOLLI.**

| NR | EMER MBIEMER | BASHKIA | FSHATI NJ.AD | LLOJI FATKEQESISE | VITI I NDODHJES | VLERA E KOMP.50 % E DEMIT (leke) | SIPAS VKB Nr …. ,DATE… | LIKUIDUAR NE VITE(leke) | | DATA E LIKUJDIMIT | | VLERA E MBETUR PER LIKUJDIM (leke) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | BASHKIA | AKMC | BASHKIA | AKMC | |
| 1 | HAJDAR RRESHKA | Lib . | Babje Qender | Lekundje sizmike | 10.12.2019 (p- verbali) | 232.982 | 44 29.05.2020 | 50 000 | | 1239 21.10.2020 | | **182.982** |
| 2 | RAMAZAN KULLOLLI | Lib | Floq Orenje | Lekundje sizmike | 16.12.2019 (p- verbali) | 261.638 | 115 28.12.2022 | 144782 | | 1359 29.12.2022 | | **116.856** |

**PERGJEGJESI I SEKTORIT TE MBROJTJES CIVILE**
**Musa Shalla**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**SEKTORI I MBROJTJES CIVILE**

Librazhd më ___/____/2024

**RELACION**

***PER AKORDIMIN e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Hajdar RRESHKA banesa e te cilit eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore (renie termeti)***

Në mbështetje të **Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015** ***"Për vetëqeverisjen vendore"****; ligjit* **Nr. 45/2019 datë 18.07.2019** ***"Për Mbrotjen Civile,"***, **VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012** *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore"*

Për familjen e shtetasit **Hajdar RRESHKA** banore i fshatit **Babje NJ/A Qender** Bashkia Librazhd ne baze te ***Vendimit te Keshillit Bashkiak nr 44 dt 29.05.2020*** gjendja rezulton si me poshte :

*Vlera e demit financiar ne banese shkaktuar nga fatkeqesia natyrore eshte ne Shumen* ***465.964*** *leke**(pika 2 e VKB-se)**. Vlera e ndihmes financiare percaktohet sipas kritereve te VKM-se nr 329 dt 16.05.2012( pika 2 e Vendimit te Keshillit Bashkiak nr 44 dt29.05.2020).*

*Bazuar ne VKM-ne nr 329dt 16.05.2012 Kreu III /3/b,ç,d) Vlera e ndihmes financiare llogaritet ne masen* ***50%*** *te vleres se demit . Pra vlera e demit financiar per banesen eshte :**465.964 leke(**sipas preventivave ne dosje)*

*Vlera e perfitimit financiar eshte :* ***465964: 2 =232.982 leke*** .

*Sipas Vendimit te Keshillit Bashkiak me nr 44dt 29.05.2020 shtetasit Hajdar Rreshka i eshte dhene ndihme emergjente ne vleren financiare ne Shumen **50 000leke** nga Buxheti i Bashkise Librazhd fondi i Emergjencave Civile. ( **me urdher shpenzimi nr 1239 dt21.10.2020)***

**Ngelet per tu likujduar: (Vlera e perfitimit financiar – Vleren e terhequr sipas urdher shpenzimit) .Pra 232982 –50.000= 182.982 leke**

.

**PËGJEGJËSI I SEKTORIT TE MBROJTJES CIVILE**
**Musa SHALLA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**SEKTORI I MBROJTJES CIVILE**

Librazhd më ___/____/2024

**RELACION**

***PER AKORDIMIN** e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Ramazan KULLOLLI*
***banesa e te cilit eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore (renie termeti)***

Në mbështetje të **Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015** ***"Për vetëqeverisjen vendore";*** *ligjit* **Nr. 45/2019 datë 18.07.2019** ***"Për Mbrotjen Civile,"***, **VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012** *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore"*

Për familjen e shtetasit **Ramazan KULLOLLI** banore i fshatit **Floq NJ/ A. Orenje** Bashkia Librazhd ne baze te ***Vendimit te Keshillit Bashkiak nr 115 dt 28.12.2022*** gjendja rezulton si me poshte :

*Vlera e demit financiar ne banese shkaktuar nga fatkeqesia natyrore eshte ne Shumen* ***523276*** *leke(**pika 2 e VKB-se**). Vlera e ndihmes financiare percaktohet sipas kritereve te VKM-se nr 329 dt 16.05.2012( pika 4 e Vendimit te Keshillit Bashkiak nr 115 dt28.12.2022).*

*Bazuar ne VKM-ne nr 329dt 16.05.2012 Kreu III /3/b,ç,d) Vlera e ndihmes financiare llogaritet ne masen* **50%** *te vleres se demit . Pra vlera e demit financiar per banesen eshte :***523276 leke(***sipas preventivave ne dosje)*

*Vlera e perfitimit financiar eshte :* ***523276 : 2 =261638 leke*** .

*Sipas Vendimit te Keshillit Bashkiak me nr 115dt 28.12.2022 shtetasit Ramazan Kollolli i eshte dhene ndihme emergjente ne vleren financiare ne Shumen **144782 leke** nga fondi i kushtezuar i buxhetit te shtetit per vitin 2022.**(me urdher shpenzimi nr 1359 dt 29.12.2022)***

**Ngelet per tu likujduar: (Vlera e perfitimit financiar – Vleren e terhequr sipas urdher shpenzimit) .Pra 261638 – 144782= 116 856leke**

**PËGJEGJËSI I SEKTORIT TE MBROJTJES CIVILE**
**Musa SHALLA**

**REPUBLKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**Sektori i Mbrojtjes Civile**

# PROJEKT - VENDIM

**Nr.______ datë ___/___/2024**

## PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO –LIGJOR DH E DHENIEN E NDIHMES FINANCIARE PER FAMILJEN E Z:YMER DAJA BANOR I FSHATIT VEHLCAN NJ/A HOTOLISHT BANESA E TE CILIT KA PESUAR FATKEQESI NATYRORE (Rreshqitje trualli)

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dt___ /___ / 2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i MC dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar " Per dhenien e ndihmes financiare per : Familjen e z: **Ymer DAJA banor i fshatit Vehlcan NJ/A Hotolisht** Bashkia Librazhd bazuar ne **:**

1-Ligji nr 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore"

2- Ligjin nr 45/2019 "Per Mbrojtjen Civile "

3- VKM nr 329 dt 16.05.2012 " Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuar nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore " .

4-VKB nr 119 dt 29.12.2023 "Per miratimin e Buxhetit te Bashkise Librazhd per vitin 2024"

**VENDOSI :**

**1-** Te miratoje dokumentacionin tekniko-ligjor te pergatitur nga Sektori i EC Bashkise per banesen e **shtetasit Y Daja** demtuar nga fatkeqesi natyrore .

**2**-Te miratoje vleren e demit ne banese ne shumen :**1631075 leke** dhe vleren e perfitimit financiar ne shumen :**815.537 leke .**

**3**-Te miratoje dhenien e ndihmes financiare ne **Vleren : 815.537 leke** nga Buxheti i Bashkise per vitin 2024 fondi i EC miratuar ne Keshillin Bashkiak me VKB nr 119 dt 29.12.2023.

**4**-Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar si dhe Sektori i EC.

**5**- Ky vendim hyn ne fuqi 10 dit pas shpalljes publike ( sipas percaktimeve te Ligjit 139/2015)

**KRYETARI I BASHKISE**
**Mariglen DISHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ___/06/2024

"PER DHENIE NDIHME FINANCIARE "

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore ", të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë " , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.97/2023"Për Buxhetin e vitit 2024" , në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhezimin nr. 22 date 30.07.2018 " Per procedurat standarte te monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" ,Udhezimi plotesues nr.1 date 24.01.2024 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024", Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/06/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare si familje ne veshtiresi(fëmijë i sëmurë) në masën 50,000 lekë për zVullnet Duka fshati Hotolisht ,Njësia AdministrativeHotolisht ,Bashkia Librazhd .
2. Fondi prej 50,000 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2024 "Ndihmë Financiare " në strukturën buxhetore si më poshtë:

| Grupi | titulli | kapitulli | artikulli | vlera | |
|---|---|---|---|---|---|
| 0 0 | 1110 | 0 1 | 606 | 50,000 lekë | Ndihmë financiare |

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori Financës .

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

**KRYETARI I BASHKISE**
**MARIGLEN DISHA**

Adresa: Sheshi " Gjorg Golemi" email: www.bashkialibrazhd.gov.al, info@bashkialibrazhd.gov.

Kabinet
Financa

2853
dt 19.06.2024

KËRKESË/ANKESË

Drejtuar Bashkisë Librazhd

DATË : ___ / ___ /2024

Drejtorisë së ........................................

Unë i/e nënshkruari/a ........................................ banues në........................................

Kërkoj nga ana e Bashkisë Librazhd drejtorisë suaj zgjidhjen e problemit tim i cili është si më poshtë:

Une i nenshkruari Vullnet Duka kerkoj nga ana e Bashkise Librazhd që të më ndihmoj me një ndihëm financiare për të përballuar shpenzimet financiare për trajtimet e nevojshme që do të duhen të ndjek për të kuruar djalin pasi vete nuk kam mundësi financiare. Ju mbetem me shprese që kerkesa ime të meret në konsideratë.

Shpresoj që kërkesa ime të meret parasysh nga ana e drejtorisë përkatëse!

Nr.Tel : 069 6243344

Nënshkrimi:

VULLNET DUKA

*(emër,mbiemër,firmë)*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E SHENDETESISE DHE E MBROJTJES SOCIALE**
**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NENE TEREZA" TIRANE**
**SHERBIMI I ONKO/HEMATOLOGJISE**

Adresa: Rruga DIBRES, 372, Tirane; Tel/Fax: + 355 4 363644 / 362

Grupi i gjakut:A(II) Rh pozitiv (+ )
ICT –DCT Negativ (-),
Pesha- 11 kg

Tirane, me 30/04/2024

# E P I K R I Z E

Femija Dion Duka , lindur me 24/02/2023 nga Librazhdi, shtrohet, ne sherbimin tone me dt 22/04/2024 , me Nr C103882 me diagnozen**: Tumor i renit dexter** dhe rezulton **me Suspekt Neuroblastome.**

**Historiku semundjes**: Sipas referimit te nenes femija para nje jave ka qene me gjendje infeksioze, me temperature dhe otorre, eshte trajtuar me antibiotike oral Ceftinex dhe klinikisht eshte permiresuar. Dy dite para hospitalizimit u zbeh, ndihej i lodhur, i plogesht, abdomeni u distendua dhe ishte i dhimbshem. Nga ekzaminimet laboratorike dhe imazherike ne spitalin e Elbasanit u vu re nje mase abdominale e madhe ne polin e siperm te veshkes se djathte dhe ne bilancin laboratorik vihet re anemi normocitare.

**Anamneza familjare:** Asgje me rendesi
**Anmaneza Vitae:** Femija i trete i ciftit, lindur nga shtatzani normale, ne term, pa probleme, PL 3200 gr, Lindje s/c. Vaxinuar sipas kalendarit.

**Ekzaminimi Objektiv**: Gjendja e pergjithshme e femijes jo e mire ne shtrim. Shume I lodhur. Lekura e zbehte por pa lezione, pa fenomene hemorragjike. Qafa e lire. Mukozat e pastra. Cor me tone ritmike, te qarta, pa sufel por me takikardi. Pulmonet me respiracion te ashper bilateralisht, me polipne, pa tirazh, pak i dobesuar ne baze dexter posterior. Abdomen I distenduar, dolent ne palpacion, me mase te palpueshme ne hypokonder dexter qe nuk arrihet te ndjehen kufinjte. Lieni nuk palpohet. Anesi pa edema. Diureze et tranzit prezent.

**Hemograma komplet 27/04/2024**:RBC- 3.49 x10^6/uL, Hgb-7.1 g/dl, HCT-23.2 %, MCV-66.5 fL, MCH-20.3 pg, MCHC-30.6g/dl, RDW-15.9 %, WBC- 12.8 K/uL, Neutrofile (Absolute)- 7.6 K/uL, Limfocite(Absolute) - 3.8 K/uL, Monocite (Absolute) – 1.3K/uL, Eosinofile(Absolute) -0.0 K/uL,Basofile (Absolute) -0.0 K/uL, Neutrofile- 59.8 %, Limfocite- 29.8 %, Monocite- 10 %, Eosinofile-0.2 %, Basofile-0.2 %, PLT- 621 K/uL, PDW-8.6fL, MPV-9.2 fL.
**Formula leukocitare:** Neutrofile shkopinj 51 %, Neutrofile segmente- 8 %, Eozinofile- - %, Limfocite- 30 %, Monocite- 11 %. PLT lame 640.000/mm3, Retikulocit-22 ‰

**Ekzaminimet biokimike:** Glukoze-77 mg/dl, Urea- 17.6 mg/dl, Creatinemi-0.25 mg/dl, Total bilirubine-0.44 mg/dL, Direkt bilirubin-0.15 mg/dL, Total protein- 6.9 g/dL, Albumin- 4.0 g/dL, Uric Acid- 4.2 mg/dL, ALT-SGPT- 10 U/L, AST-SGOT – 77 U/L, GGT-25 U/L, ALP-677 U/L, **LDH- 2644 U/L,** CK- 91 U/L, Iron-13.0ug/dL, Calcium-9.7 mg/dL, Magnesium- 2.33 mg/dL, Phosphorus- 4.5 mg/dL, CRP-4.47 mg/dL, G6PD-14.60 U/gHgb, Na-132 mmol/L, K -4.6 mmol/L, Cl-106mmol/L.
PT (Quik time)- 90%, INR- 1.07 %, aPTT-23.8 sec, Fibrinogen Activity-401 mg/dL.
HIV 1&2 Ab,RDT-negativ.
Beta-hCG - <2.30 IU/L (neg), AFP- 9.8 ng/mL (neg), Ferritin-181.14 ng/mL.
HBsAg-0.23 S/CO, Anti- HCV- 0.07 S/CO, CMV IgM-0.11 Index, CMV Toxo IgM-0.09 Index.
**Elektroforeza e Hb:** A(HbA)- 95.8 %, A2(HbA2)-2.4 %. HbF 1.8%

**Echo abdominale dt 29/04/2024:** Formacion I madh ne llozhen surrenale dext, me kalcifikime ne brendesi, zona nekrotike ne brendesi me dimensione 7.9 x 8.9cm qe zhvendos te gjitha strukturat perreth, zhvendos renin anteriorisht qe shkon deri ne kufije me venen cava por pa e infiltruar ate. Aspekti sugjeron nje neuroblastome. Limfonoduj retroperitoneal te shumte, disa prej tyre me mikrocalcifikime. Ren sin me staze pielokaliciene gr 1. Lien normal. Llozha surrenales sin e lire. Rekomandohet CT total body me KIV

**CT koke-Thorax- Abdomen dt 30/04/2024 (ne pritje te pergjigjes, shiko CD bashkengjitur)**
Ne koke:.
Ne thorax:
Ne abdomen:

NSE, HVA dhe VMA jane marre, ne pritje te pergjigjes.
Planifikuar biopsia – te Enjten (date 2 Maj 2024)

Per informacion te metejshem mund te na kontaktoni ne email: dukaenkeleda@gmail.com, ose tel 00355692935971.

I leshohet epikriza me kerkesen e familjareve.

**Mjeku Kurues.**

Dr.Enkeleda Duka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**NJËSIA ADMINISTRATIVE HOTOLISHT**

Hotolisht më 22/05/2024

# Vlersim Socialo-Ekonomik

Bazuar në verifikimin e kryer në familjen e Z.Vullnet Selim Duka, banues në fshatin Hotolisht,Njësia Administrative Hotolisht,Bashkia Librazhd. Rezulton se Z.Vullnet Duka jeton në kushte jo të mira ekonomike.

Djali i vogël i Z.Vullnet vetem katërmbëdhjetë muaj është diagnostikuar me një sëmundje të rëndë dhe është dërguar për kurim në Itali. Sëmundja nga e cila vuan është masë tumorale e cila kërkon një trajtim të gjatë në kohë gjë qe sjell dhe nevojë për mbështetje financiare.

**ADM/SHOQEROR**

**ARDIAN POÇI**

**ADMINISTRATORI**

**FLORIAN MNALLA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE HOTOLISHT
BASHKIA LIBRAZHD

1869
2019

Bambino Gesù

*Roma 2 maggio 2024*

**A CHI DI COMPETENZA**

*Con riferimento alla richiesta di cure per il paziente* ***DION DUKA****, nato il 24/02/2023, residente in Albania, passaporto N. BG9174527, l'Ospedale Pediatrico Bambino Gesù dichiara che il paziente è atteso per un ricovero urgente presso il reparto di Onco-Ematologia in data* ***03/04/2024*** *come concordato dal Prof. Franco LOCATELLI.*

*Sarà accompagnata da:*

Miranda Duka (mamma) nata il 03/01/1982 - C.I. n. B12684582 .

*Siamo a disposizione per ulteriori informazioni possano essere utili.*

*Cordiali saluti*

*Maria Osti, MD*

Maria Osti

Ospedale Pediatrico Bambino Gesù

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Bashkia** Librazhd

**Njësia administrative** Hotolisht

**Zyra e Gjendjes Civile** 140

Datë: 05.05.2024

# CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Datëlindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Persona |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Vullnet DUKA | Selim | Feride | M | Kryefamiljar | 17-06-1975 | I/e martuar | Dardhë, Librazhd | Shqiptare | H5061701 |
| 2. | Miranda DUKA | Riza | Sanije | F | Bashkëshorte | 03-01-1982 | I/e martuar | Dardhë, Librazhd | Shqiptare | I25103132 |
| 3. | Ervin DUKA | Vullnet | Miranda | M | I Biri | 13-07-2001 | Beqar/e | Librazhd | Shqiptare | K1071302 |
| 4. | Mirseda DUKA | Vullnet | Miranda | F | E Bija | 03-12-2005 | Beqar/e | Librazhd | Shqiptare | K5620301 |
| 5. | Dion DUKA | Vullnet | Miranda | M | I Biri | 24-02-2023 | Beqar/e | Librazhd | Shqiptare | M3022400 |
| 6. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 7. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 8. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 9. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 10. | ----------------- | | | | | | | | | |

Kjo certifikatë lëshohet për ______________________

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2024/05/05 11:31:56 +02'00'
a0b2dee0b36348d5945062e42b614f11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**KRYETARI**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr_____ Datë ___.___.2024**

**Për një ndryshim dhe shtesë në VKB-në Nr. 108, dt 30.11.2023**

***"Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në Bashkinë Librazhd për vitin 2024"***

Mbështetur në Ligjin Nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 *"Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës"*, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 3, datë 28.12.2016 *"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave"*, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Projekteve dhe Investimeve me Drejtorinë e Taksave Vendore dhe të Tregjeve, i propozohet për miratim Këshillit Bashkiak , në mbledhjen e datës ____.____. 2024,

**TË VENDOSI:**

Në VKB-në Nr. 108, dt 30.11.2023 *"Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në Bashkisë Librazhd për vitin 2024"*, të bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë cituar:

1. Në pikën 5.1 të Kapitullit I *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja"*, të VKB-së së sipërcituar do të shtohen:
    - Ndërtimet për parkimet e mbuluara dhe bodrumeve;
    - Ndërtimet e realizuara me deklaratë paraprake punimesh;

    Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këto tipologji ndërtimesh është e përcaktuar sipas tabelës së paraqitur në pikën 2 të këtij vendimi;

2. Në pikën 5.1 të VKB-së, tabela ekzistuese korigjohet dhe do të zëvendësohet me tabelën si më poshtë cituar:

| Nr. | TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË | Në % mbi vlerën e investimit ose çmimit të shitjes |
|---|---|---|
| 5.1.1 | Ndërtesa të reja në funksion të banimit deri në 2-kate (për strehim) dhe bodrume | 1% e vlerës së investimit |
| 5.1.2 | Ndërtesa publike (zyra, shkolla, qendra shëndetësore) | 1% e vlerës së investimit |
| 5.1.3 | Rikonstruksion të çdo lloj ndërtese ekzistuese | 2% e vlerës së investimit |
| 5.1.4 | Ndërtime për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, të cilat nuk destinohen për përdorim në turizëm, industri apo publik | 6% e çmimit të shitjes për $m^2$ |
| 5.1.5 | Ndërtimet për parkimet e mbuluara dhe bodrumeve të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi | 4% e çmimit të shitjes për $m^2$ |
| 5.1.6 | Për ndërtesat që janë në proces legalizimi, kur subjekti posedon vetëm një objekt | 0.5 % e vlerës së investimit |
| 5.1.7 | Ndërtesat e tjera të çdo lloji që nuk citohen më lart | 3% e vleres së investimit |
| 5.1.8 | Për ndërtesat që janë në proces legalizimi, kur subjekti posedon më shumë se një objekt, për objektin jopreferencial | Sipas masës së përcaktuar në pikat me lart sipas llojit të objektit |
| 5.1.9 | Projektet e infrastrukturës për ndërtimin e rrugëve kombëtare, tunele, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte | 0.1% e vlerës, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar |
| 5.1.10 | Ndërtimet e realizuara me deklaratë paraprake punimesh | 1% e vlerës së investimit |

3. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Projekteve dhe Investimeve, Drejtoria e Taksave Vendore dhe e Tregjeve, si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**

**MARIGLEN DISHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**RELACION**
**PËR PROJEKT-VENDIMIN**

**"Për një ndryshim dhe shtesë në VKB-në Nr. 108, dt 30.11.2023 *"Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në Bashkisë Librazhd për vitin 2024""***

Mbështetur në Ligjin Nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, Ligjin Nr. 107/2014 *"Për planifikimin e territorit"* i ndryshuar, VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 *"Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës"*, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 3, datë 28.12.2016 *"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave"*, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim mes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Projekteve dhe Investimeve me Drejtorinë e Taksave Vendore dhe të Tregjeve, i parashtrojmë Këshillit Bashkiak kërkesën për të bërë ndryshime dhe shtesa në VKB-në Nr. 108, dt 30.11.2023 *"Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në Bashkinë Librazhd për vitin 2024"*.

Ndryshimet e propozuara prekin pikën 5 të kapitullit të I, *"Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja"*, konkretisht **korigjimin dhe saktësimin** në tabelën e paraqitur në pikën 5.1 të përshkrimit të % së taksës mbi vlerën e investimit ose të çmimit të shitjes në mënyrë që të shmanget çdo paqartësi në përllogaritjen e saktë të vlerës për çdo rast konkret.

Në pikën e parë *5.1.1 "Ndërtesa të reja në funksion të banimit deri në 2-kate (për strehim)"* do të saktësohet/shtohet ***dhe bodrumet*** që janë ndërtuar në funksion të këtyre ndërtesave, të cilat taksohen me të njëjtën vlerë që kjo pikë ka të përcaktuar 1%, në mënyrë që të jetë e përcaktuar qartë dhe mos të ketë vend për interpretim në përllogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë tipologji ndërtimesh.

Propozojmë të shtojmë një pikë tjetër ***"ndërtimet për parkimet e mbuluara dhe bodrumeve të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi"*** të cilat do të taksohen në masën 4% të

çmimit të shitjes për m$^2$, si nëndarje të pikës 5.1.4. Deri më tani taksa për këtë kategori ndërtimi mbahej në bazë të pikës *5.1.4 "Ndërtime për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, të cilat nuk destinohen për përdorim në turizëm, industri apo publik"* dhe taksohej në masën prej 6% të çmimit të shitjes. Duke marë parasysh që bazuar në nenin 27, pika 2 e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e destinuara për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi është në masën 4-8% të çmimit të shitjes për m$^2$, e shikojmë të arsyeshme që parkingjet e mbyllura dhe bodrumet të jetë në vlerën prej 4%.

